


Fatos Arapi

BIBLIOTEKA

854-1
A 73



KU
SHKONI
JU, STATUJA...
poezi

8PL883-1

814-1
A73

FATOS ARAPI

KU SHKONI JU,
STATUJA...

poezi



SHTËPIA BOTUESE «NAIM FRASHERI»


Redaktore
SEVIM ARBANA

Piktor
KSENOFON DILO

Recensues

Bardhyl Londo
Besnik Mustafaj

Endrra
tē mia...



QENKA MË VËSHTIRE ...

Më lodhi avalanshi i figurave poetike...

*Qenka më vështirë t'i thuash botës
diçka të kthjellët (të vogël?), —*

*t'i thuash, për shembëll: ja, unë u ula
e nën qiparisa i mora dy gogla,
e me to po lozja, si lozim përditë —
kur pa e kuptuar vargun e madh e përfola:*

«Urrej gjithë perënditë»¹.

*Qenka shumë më vështirë t'u thuash njerëzve
diçka të pathënë, të ndershme,
t'u thuash, për shembëll:*

*ju u ngjani fëmijëve,
që gjumi s'i zë pa lodrat e vogla nën përkresë.
I kërkojnë nëpër gjumë,
me duar i shtrëngojnë gjer nesër.*

Ashtu mbani ju nëpër jetë dashuritë.

Më lodhi avalanshi i figurave poetike, ::.

1. Varg nga «Prometeu i lidhur» i Eskilit

ENDRRA TE MIA...

Endrra,
ju jeni tē rënda
Shpeshherë kërrusem
rën barrën tuaj.

Ju ngarkoni mbi mua
grimcëza dritash mendimi,
rrezëllime tē gëzueshme lirie,
dhimbje epokash tē tëra. *islep*

(Mbi shpatullat e rrizuillit ato po t'i hidhnit,
do ta shihja si do t'i palosej
peshku i kurrizit).

Ju jeni gatuar prej tē gjithave:
prej gjuhësh tē panumërtë dashurish,
pëshpërima muzgjesh

e paqesh.

Endrra,

*ju jeni të rënda;
ju ngarkoni mbi mua kafshimet e urive,
Fytyrat e përgjakura, të dhemshura të lirive;
ju ngarkoni mbi mua varrezat e dëshmorëve
 të të gjitha kohëve,
 të të gjithë popujve*

*Dhe bri tyre — si ata —
ju vetë bini tek unë
nëpër funerale gjigante ashtu . . .*

*Endrra tē mia,
ju jeni tē rënda.
Dhe unë s'e kam lehtë me ju . . .*

NJË PËRKRESE ME GJETHE ULLIRI TE KOKA ...

*Një përkresë me gjethë ulliri te koka. —
Nuk vdes sot. Le ta lëmë për nesër ...*

*Gjelbërosh gjer në palcë, si ulliri,
do të punoj në veten time
ekzistencën e dhimbshme të kohës, —
ta ushtroj atje poshtë të mos ndalet:
cerberët do të jenë ca kulishë të zbutur;
karontët pe gjasme, si në teatrin e kukullave.
Vetëm lumi le të jetë i vërtetë,
të rrjedhë duke kënduar këngët*

polifonike të tij.

*Prej kohe në brigjet e Akeronit jam një ulli i gjel-
bër. —*

Dhe nuk vdes sot.

Një përkresë me gjethë ulliri te koka.